REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 134/17
Date/Datum 26.05.2017
PRISHTINË / PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	**134/17**
PËR:	- Zyrtarin e prokurimit të AK-së: **Komuna e Gjilanit** - Parashtruesit të ankesës: **"Telekomi i Kosovës"- SH.A.**
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Sabrije Bullatovci - Ekspert Shqyrtues i Prokurimit Bullatovci
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar: **"Telekomi i Kosovës"- SH.A**, me numër protokollit: **134/17**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbime të telefonisë mobile për Komunën e Gjilanit", me nr. të prokurimit: 651/17/1163/221**, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues: (AK) – Komuna e Gjilanit.

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	**26.05.2017**
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbime të telefonisë mobile për Komunën e Gjilanit", me nr. të prokurimit: 651/17/1163/221,** iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **Komuna e Gjilanit,** si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues: **"Telekomi i Kosovës"- SH.A.**, me numër protokollit: **134/17.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:
AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bujtati		18.05.2017		19.05.2017		26.05.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të ekspertizës*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: **10.05.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **134/17,** e parashtruar nga OE: **"Telekomi i Kosovës"- SH.A.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shërbime të telefonisë mobile për Komunën e Gjilanit"**, me nr. të prokurimit: 651/17/1163/221, iniciuar nga autoriteti kontraktues: (AK)– **"Telekomi i Kosovës"- SH.A.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 111, LPP - Operatori Ekonomik Ankues: "Telekomi i Kosovës"- SH.A.

Pikat e Ankesës:

- Shkelje e nenit 9.4 të LPP-së, Përcaktimi i nevojave qe duhet te përmbushën.
- Shkelje e nenit 24.2 të LPP-së, Zyrtaret e Prokurimit gjatë ushtrimit te aktivitetit të prokurimit.
- Shkelje e nenit 108/A të LPP-së, Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve
- Shkelje e nenit Neni 109 të LPP-së, Afatet për dorëzimin e Ankesës.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Neni 9.4 — Përcaktimi i nevojave qe duhet te Përmbushen

- Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese qe te veprojnë si ne vijim: autoriteti kontraktues kur është autoritet publik, autoriteti i publik duhet marre masa te arsyeshme për t'u siguruar se lendet qe i përmbushin këto nevoja pukjane ne dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik". Pra neni i larte cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevoje për sigurimin e shërbimeve operator i te cilave po ashtu është një autoritet publik, për me tepër edhe interpretimi i KRPP-se thekson se një autoritet kontraktues publik nuk ka nevoje te procedoj ndonjë procedure te prokurimit përderisa një shërbim ofrohet nga një autoritet tjetër kontraktues publik. Shih citatin e KRPP-se:

Citati:

36. Duke marr për baze dilemat e shfaqura te Autoriteteve Kontraktuese dhe, kërkesat e shumta te tyre (drejtuar KRPP-se) qe behet e qartë se si duhet te veprohet ne rastet kur një Autoritet Kontraktues (Autoritet Publik) ka nevojë për sigurim te shërbimeve ofrohet një Autoritet tjetër po ashtu publik?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 te Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, KRPP ofron interpretim ligjor si ne vijim:

Sa i përket çështjes se parashtruar me larte, Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 9 paragrafi 4, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese qe te veprojnë si ne vijim:

"Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë duhet te marre masa te arsyeshme për t'u siguruar se lendet qe përmbushin këto nevoja nuk janë ne dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik".
Pra neni i lartë cituar rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues (Autoriteti Publik) ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i te cilave po ashtu është një autoritet publik.
LPP, nuk e sqaron me tej se si autoritet publike do te rregullojnë plotësimin e nevojave te tyre (ne mes vete) nëse kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.

Mirëpo, është me se e qarte se këto raste kane te beje me përjashtimet nga zbatimi i legjislacionit (le rregullon prokurimin publik kur një forme e partneritetit publiko privat realizohet (një AK mund te kërkojë ofrimin e një shërbimi ne shërbimet e tije ose shërbimeve te një autoriteti tjetër kontraktues pa iniciuar ndonjë procedure tenderimi, te ashtuquajtura përjashtim " ne shtëpi).

Si përfundim pas analizimit te cekur me lart (neni 9.4 te LPP-se) dhe te kërkesave tuaja, me qe nuk ka asnjë dispozite tjetër te LPP-se e cila i obligon Autoritetet Publike qe te marrin masa për te mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-se, neni 12.1) KRPP nuk ka se si te mos e trajtoje ketë çështje ashtu sikur është vendosur ne nenin 9.4 te LPP-se.

Njoftim për te gjitha autoritetet kontraktuese

Njoftohen te gjitha autoritetet kontraktuese se KRPP është duke monitoruar ne vazhdimësi te gjitha Llojet e Njoftimeve te përgatitura nga autoritetet kontraktuese. Gjate këtij procesi është konstatuar se një numër i konsiderueshëm I autoriteteve kontraktuese ende po përdorin (sidomos për kontrata kornize) kriterin e vlerësimit "çmimi për njësi" pa specifikuar sasinë e përafërt dhe ose pa përdorur peshimin e çmimit për "kategori te shërbimeve" ose secilit "artikull".

KRPP e konsideron se lidhja e kontratave me çmime për njësi pa e caktuar sasinë ne Njoftimin për Kontrate dhe ne dosjen e tenderit dhe/ose pa aplikuar metodën e "peshimit" konsiderohet shkelje te dispozitave ligjore (nenit 38 paragrafi 2 dhe 52, paragrafi 6) te Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurirnin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Kur kriter për dhënie te kontratës ne Njoftimin për Kontrate dhe ne Dosjen e Tenderit caktohet: "tender/ i përgjegjshëm me çmimin me te ulet" dhe ne rastin e kontratave për shërbime te shumëfishta ose ne rast te kontratave me çmime për njësi kur sasia është përcaktuar si sasi indikativë, çmimet mund te peshohen ne baze te rëndësisë se secilës kategori te shërbimeve" " ose secilit "artikull " ne mënyre qe autoriteti kontraktues te përcaktoje se cili' është oferta me çmimin më te ulet. (shih paragrafin 61c nenit 52 te këtij ligji). Për këtë qellim, KRPP ka nxjerr dhe ju duhet te referoheni ne UA 0312015 se bashku *me* shpjegimin "rast studimi" ne mënyre qe te shmanget shkelja e dispozitave te cekura me lart dhe te lidhen kontrata jo ligjore.

KRPP, nuk do le publikoj asnjë lloj Njoftimi (Njoftimi për kontrate, Njoftimin për dhënie apo për nënshkrimin e kontratës) dhe do te deklaroj aktivitetet, vendimet dhe/ose kontratat Jo ligjore ne rast se nuk lëne respektuar dispozitat e cekura me lart apo cila do dispozite tjetër e legjislacionit për prokurim publik.

LINKU: hups://krppsks-gov.net/Default.aspx?PID=NeësPub&LID-18cPCID=- I &Ct111)=1' ITMLStatic&CID=PPRCNeës&ID=313

Neni 24.2 - Zyrtaret e prokurimit gjate ushtrimit te aktiviteteve te prokurimit

Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 24 paragrafi 2, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese qe te veprojnë si ne vijim: "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për te siguruar qe te gjitha aktivitetet e prokurimit te autoritetit te tille kontraktues te ekzekutohen ne përputhshmëri te plote me këtë ligj". Bazuar ne këtë nen konsiderojmë se AK Kuvendi Komunal Gjilan ka bere shkelje ligjore gjate zhvillimit te aktivitetit te prokurimit 651-17-1163-2-2-1.

Neni 1.08/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 108/A paragrafi 2, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese qe te veprojnë Si ne vijim: "Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues qe automatikisht te pezulloj zbatimin e aktivitetit te prokurimit me te cilin ka te beje shkelja e pretenduar".

Kjo pike është plotësuar nga KRPP edhe me aktin dytësor "Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave" ku neni 6 "Pezullimi i aktivitetit te prokurimit" paragrafi 6.1, parasheh ne mënyrë specifike qe "Ushtrimi i kërkesës për rishqyrton automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe ne këtë rast Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, duhet te njoftoj me shkrim te gjitha palët e interesuara lidhur me pezullimin e procedurës se prokurimit ne fjale".

Bazuar ne këtë nen konsiderojmë se AK Kuvendi Komunal Gjilan ka bere shkelje ligjore gjate zhvillimit te aktivitetit te prokurimit 651-17-1163-2-2-1, pasi qe nuk ka pezulluar zbatimin e aktivitetit te prokurimit.

Kjo për faktin se Telekomi i Kosovës sh.a. jo vetëm qe nuk është njoftuar me shkrim lidhur me pezullimin e procedurës se prokurimit ne fjale, përkundrazi AK Kuvendi Komunal Gjilan, një dite pas Kërkesës për Rishqyrtim, me datën 27.04.2017 ka bere korrigjimin e dosjes tenderuese.

Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 108/A paragrafi 6, kërkon nga Autoritetet Kontraktuese qe te veprojnë Si ne "Autoriteti kontraktues do ía shqyrtoje kërkesën brenda ire (3) dite pune nga data e dorëzimit te aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes se informative shtese dhe dokumenteve te parashikuara ne paragrafin 5 te këtij neni. Afati 1 përmendur me lart, ne raste specifike te justifikuar mund te zgjatet për jo me shume se tre (3) dite shtese, dhe ankuesi do te informohet për këtë". Bazuar ne këtë nen konsiderojmë se AK Kuvendi Komunal Gjilan ka bere shkelje ligjore gjate zhvillimit te aktivitetit te prokurimit 651-17-1163-2-2-1, pasi qe AK Kuvendi Komunal Gjilan nuk ka shqyrtuar kërkesën brenda tre (3) dite pune nga data e dorëzimit te aplikimit. Kërkesa për Rishqyrtim pranë AK Kuvendi Komunal Gjilan është bere nga ana e Telekomit te Kosovës me date 26.04.2017, kurse njoftimin për refuzim te Kërkesës për Rishqyrtim kemi marre me date 05.05.2017

Neni 109 - Afatet për Dorëzimin e Ankesës

Ligji për Prokurim Publik gjegjësisht neni 109 paragrafi 2, kërkon qe pas udhëheqjes se një procedure paraprake për zgjidhje te mosmarrëveshjes me Autoritetet Kontraktuese, te veprohet si ne vijim: "Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorëzohen brenda dhjete (10) ditëve pas vendimit te lëshuar nga autoriteti kontraktues ne procedurën paraprake te zgjidhjes se mosmarrëveshjes ne përputhje me nenin 108/A te këtij ligji".
Bazuar ne këtë nen konsiderojmë se AK Kuvendi Komunal Gjilan ka bere shkelje ligjore gjate zhvillimit te aktivitetit te prokurimit 651-17-1163-2-2-1, pasi qe nuk ka mundësuar afatet ligjore për dorëzim te ankesës pranë 0ShP-se. AK Kuvendi Komunal Gjilan vendimin për refuzim te Kërkesës për Rishqyrtim e ka marre me date 05.05.2017 dhe nuk ka ndryshuar datën për dorëzim te tenderëve 10.05.2017.

PROPOZIMI I TELEKOMIT TE KOSOVES

Te anulohet Njoftimi për kontrate nga KUVENDI KOMUNAL GJILAN dhe te fillohet një procedure e re ne përputhje me interpretimin e KRPP-se dhe ne kërkesat e nenit 9.4 te LPP-se. Dmth KUVENDI KOMUNAL GJILAN nuk ka nevoje te përdor procedure te prokurimit, pasi qe shërbimet ofrohen nga një institucion publik qe përdor fonde publike.

Mënyra proceduese se anulimit është: KUVENDI KOMUNAL GJILAN duhet te kërkoj nga KRPP ose autorizim qe te beje anulimin e Njoftimit për kontrate.

Dëmet material:

Demet materiale qe mund ti shkaktohen nga përdorimi i LPP-se nga ana e KUVENDI KOMUNAL GJILAN janë shume te mëdha dhe ne vlere monetare ato mund te shkojnë me mijëra euro, përafërsisht 22.000,00 euro për 36 muaj. Këto dëme ne mënyrë te drejtpërdrejtë dëmtojnë BUXHETIN e KOSOVES pasi qe TELEKOMI i KOSOVES është ndërmarrje publike dhe siç e ka përcaktuar KRPP konsiderohet blerje ne SHTEPI.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP:.....13.04.2017

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e Hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....Shërbime/vlerë e Mesme

Vlera e parashikuar e kontratë: .....22,000.00 Euro

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 10.05.2017

Data e hapjes së ofertave:.....10.05.2017

Kriteret për vlerësim:

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60): ..... Tenderi i përgjegjshëm,ekonomikisht më i favorshëm i përcaktuar sipas kriterit të përshkruar në Aneksin 6.

III.2) **KUSHTET PËR PJESËMARRJE**

III.2.1) ***Kërkesat e përshtatshmërisë:***

a. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a, b, c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit themelimit të tenderuesit. b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situate e tillë nuk ekziston. c. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës] Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i B05 Njoftim për Kontratë dokumenteve dhe certifikatave që

referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme. - Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2. - Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik, se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues). - Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se Operatori Ekonomik nuk është i falimentuar ose likuiduar (Kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vlen për OE fitues).

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.
Certifikata për Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK.
Licenca nga ART.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).
Certifikata e numrit fiskal (kopje).
Certifikata për regjistrim në TVSH (kopje).
Licenca e lëshuarnga ART (kopje).

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Dëshmia e kërkuar dokumentare:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional
Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku dy referenca të mira në 3 (tre) vitet e fundit 2014, 2015, 2016.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Listën nga Operatorit Ekonomik se ka referenca të mira nga ndonjë kompani apo organizatë (sektori publik apo privat).

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi
1.	"IPKO TELECOMUNICATIONS"	Prishtinë	6,249.53 €

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se në hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesi i OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.

Analiza dhe sqarimet e ekspertëve shqyrtues (N. 113, 114)

Sqarimi Nr.1:

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit me titull: **"Shërbime të telefonisë mobile për Komunën e Gjilanit"**, me nr. të prokurimit: 651/17/1163/221, ka aplikuar procedurën e hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike kornizë 36 muajsh, furnizim, vlerë e mesme. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sqarimi Nr.2:

Bazuar ne shkresat e lëndës, ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik ankues me dt. 26 prill 2017, ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Shërbime të telefonisë mobile për Komunën e Gjilanit"**, me nr. të prokurimit: 651/17/1163/22, në autoritet kontraktues K. Gjilan.

Autoriteti kontraktues K. Gjilanit, me dt. 05 maj 2017, i kthen përgjigje operatorit ekonomik ankues duke e refuzuar kërkesën për rishqyrtim, ku ndër të tjera thuhet: *pika 4 e nenit 9, nuk e sqaron mirë këtë çështje si dhe udhëzimi, përkatësisht sqarimi të cilin e ka dhënë KRPP-ja. Po ashtu nuk ka mundësuar që autoritetet kontraktues apo operatoret ekonomik të interesuar të mbështeten shumë në të, që nënkupton se nuk është mjaft i kuptueshëm ashtu sikur që edhe vet LPP-ja. Ne konsiderojmë se në rastin konkret jemi duke zbatuar procedurën me transparente-procedurën e hapur, duke pasur para sysh se në Republikën e Kosovës, operojnë edhe dy operatorë tjerë të licencuar nga ARKEP të cilët e kanë veprimtarin e njëjtë si të tuajën.*

Sqarimi Nr.3:

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 9 paragrafi 4 të LPP-së, ekspertja shqyrtues sqaron, lidhur me këtë çështje KRPP-ja ka dhënë interpretim ku ndër të tjera thuhet: pas analizimit të cekur më lartë (neni 9.4 të LPP-së) dhe të kërkesave tuaja, meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-ës e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar "shtrembërimin e konkurrencës" (sikur ato nga direktiva e BE-së, neni 12.1), KRPP nuk ka se si të mos e trajtojë këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 te LPP-së.

Ekspertja shqyrtues bazuar në interpretimin e KRPP-së për këtë çështje, sqaron se në rastin konkret: Telekomi i Kosovës është autoritet publik sipas interpretimit të KRPP-së, andaj duke i marruar për bazë dilemat e shumta të shfaqura nga Autoritetet kontraktuese në lidhje me këtë çështje, në bazë të interpretimit të KRPP-së autoritetet kontraktues duhet të veprojmë në harmoni me nenin 9.4 të LPP-së, në lidhje me këtë çështje.

Sqarimi Nr.4:

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 108/A paragrafi 2 të LPP-së, respektivisht ku ceket: "*Bazuar ne këtë nen konsiderojmë se AK Kuvendi Komunal Gjilan ka bere shkelje ligjore gjate zhvillimit te aktivitetit te prokurimit 651-17-1163-2-2-1, pasi qe nuk ka pezulluar zbatimin e aktivitetit te prokurimit*", ekspertja shqyrtues gjatë shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, sqaron se nuk ka hasur në ndonjë shkresë që dokumenton se është pezulluar aktiviteti i prokurimit dhe me këtë pezullim është njoftuar operatori ekonomik ankues, ashtu siç parashihet ne nenin 108/A paragrafi 2 ku thuhet: "*Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar*".

Sqarimi Nr.5:

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku thuhet: "*Komunal Gjilan nuk ka shqyrtuar kërkesën brenda tre (3) dite pune nga data e dorëzimit te aplikimit. Kërkesa për Rishqyrtim pranë AK Kuvendi Komunal Gjilan është bere nga ana e Telekomit te Kosovës me date 26.04.2017, kurse njoftimin për refuzim te Kërkesës për Rishqyrtim kemi marre me date 05.05.2017,* ekspertja shqyrtues sqaron se nëse merret parasysh data e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim nga operatori ekonomik ankues dt. 26 prill 2017, me datën e vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të autoritetit kontraktues (dt. 05 maj 2017), rezulton se autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 6.3-Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave-F03-KRPP.

Sqarimi Nr.6:

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues ku ceket se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 109 të LPP-së, respektivisht ku thuhet: "*Bazuar ne këtë nen konsiderojmë se AK Kuvendi Komunal Gjilan ka bere shkelje ligjore gjate zhvillimit te aktivitetit te prokurimit 651-17-1163-2-2-1, pasi qe nuk ka mundësuar afatet ligjore për dorëzim te ankesës pranë OShP-se*", ekspertja shqyrtues sqaron se nëse i referohemi nenit 8.1.1. **pika iii-** Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave-F03-KRPP, ku shprehimisht ceket: "*Kurdo qe refuzimi i kërkesës ndërlidhet me **njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit**, Autoriteti Kontraktues do te vazhdoj me tutje me procedurën e prokurimit*", rezulton se autoriteti kontraktues nuk ka bërë shkelje të nenit 109 të LPP-së.

Sqarimi Nr.7:

Ekspertja shqyrtues bazuar në dosjen e tenderit sqaron se autoriteti kontraktues në nenin 30.1 të FTD, si kriter për dhënie të kontratës ka specifikuar tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht me të favorshëm, ndërsa në Aneksin 6 të dosjes së tenderit janë cekur nën kriteret e vlerësimit, mirëpo nuk janë cekur koeficientet apo peshën e secilit nen kriter, në bazë të cilit do të bëhet vlerësimi.

Ekspertja shqyrtues bazuar në faktin se autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratë e ka specifikuar tenderin e përgjegjshëm ekonomikisht me të favorshëm, sqaron se në rastin konkret autoriteti kontraktues me rastin e mos specifikimit të peshës së secilit nën kriter në Aneksin 6 të dosjes së tenderit, nuk ka respektuar nenin 52 paragrafi 2 të LPP-së, ku thuhet: "*Nëse autoriteti kontraktues ka specifikuar se kontrata publike do t'i shpërblehet operatorit ekonomik që ka paraqitur tenderin ekonomikisht më të favorshëm, autoriteti kontraktues në fjalë duhet të specifikojë në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit kriteret që do të merren parasysh gjatë vendosjes së fituesit dhe peshën që i është dhënë secilit kriter. Sa më shumë që është e mundshme, autoriteti kontraktues duhet të specifikojë çdo kriter në mënyrë objektive dhe kuantitative si dhe duhet të shprehë peshën që i është dhënë atyre*".

Mendimi i ekspertit shqyrtues:

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e prokurimit **"Shërbime të telefonisë mobile për Komunën e Gjilanit"**, me nr. të prokurimit: 651/17/1163/221, i propozon panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues ta aprovoj si të bazuar, ndërsa të anuloj vendimin- njoftimin për kontratë, të dt. 13 prill 2017, dhe lëndën ta kthej në Ri-tenderim.